



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 72/ 12 prot.

Datë 31.01.2024

V E N D I M

Nr. 115/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 31.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 21.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1

Ankimues:

Operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK me NIPT L64715601E dhe adresë: Lagjja nr.1, Zona Industriale Pogradec, Nr. pasurie 13/124, Zona Kadastrale 858, Pogradec.

Autoriteti Kontraktor:

Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, me adresë Rr. “Arben Broci”, Qyteti Studenti Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë përmes sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.11.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 21.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se më datë 21.12.2023, është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se në datën 05.01.2024, është bërë vlerësimi i procedurës dhe klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ku ankimuesi rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik “IGLI PELLET” SH.P.K me nipt: NIPT L64715601E nuk plotëson pikën 2.3 të kapaciteteve teknike lidhur me kontratat e ngjashme pasi ka paraqitur vetëm vërtetimin për realizimin të pashoqëruar me fatura elektronike të institucioneve shtetërore, çka bie në kundërshtim me përcaktimin Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë

vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativorit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 11.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024, e operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 72/2, datë 12.01.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.6. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 15.01.2024 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.7. Përmes shkresës së protokolluar me tonën me nr. 72/3 prot., datë 19.01.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar fotokopje të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën nr. 1314/21 prot, datë 19.01.2023, me objekt: “*Informacion*”, protokolluar me tonën me nr. 72/4, datë 22.01.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK, bashkëlidhur së cilit gjendet dokumenti me nr. 1314/18 prot., datë 19.01.2024, me lëndë “Shqyrtim Ankesë”. Referuar dokumentit më sipër, dy prej anëtarëve të KSHA, kanë vendosur mospranimin e ankesës (e cila sipas informacionit të tyre është paraqitur në protokollin e shoqërisë me nr. 1314/15 prot, datë 15.01.2024) me argumentimin, se ankimuesi me dokumentacionin e dorëzuar, nuk plotëson të gjitha kriteret për kualifikim, ndërsa njëri prej anëtarëve të KSHA ka dalë me mendim paralel ,duke vendosur mospranimin e ankesës me arsyetimin, se ankesa e operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK e depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave më datë 11.01.2024, konsiderohet si e paraqitur përpara afatit, duke mos u legjitimuar.

II.9. Më datë 25.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 72/5 prot., operatori ekonomik “Igli Pellet”, ka paraqitur përmes sistemit të ankesave elektronike, formularin e paraqitjes së argumenteve.

II.10. Me shkresën e datës 23.01.2024, me lëndë “Ankesë” dhe objekt: “Dërgimi i argumenteve/kundërshtimeve në lidhje me Vendimin e Komisionit të Ankimit” protokolluar me tonën me nr.72/6 prot., datë 29.01.2024, operatori ekonomik “Igli Pellet” ka kundërshtuar vendimin e KSHA për skualifikimin e tij, ku ndër të tjera shprehet se: “*Së treti; Saktësojmë që*

procesi i vlerësimit të ofertave është kryer me datë 05.01.2024, konfirmimi i njoftimit të fituesit është aprovuar në SPE me datë 15.01.2024 dhe njoftimi i fituesit është publikuar me date 15.01.2024 dhe ankesa jone juridikisht është administruar nga ana Juaj me date 15.01.2024 date me te cilin është publikuar edhe njoftimi i fituesit dhe fillon afati i ankimit i dërguar në S.P.E qe korrespondon me protokollimin e ankesës ne institucionin e A.Ksë, vërtetuar kjo me nr. Prot 1314/15, datë 15.01.2024.”

II.11. Me memon e datës 31.01.2024, me nr.72/7 prot., KPP i kërkoi Sektorit të Financës Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, si dhe Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit në KPP, informacionin si vijon *“[...] Duke qenë se operatori ekonomik ankimues pretendon se” ankesa jone juridikisht është administruar nga ana Juaj me date 15.01.2024 date” me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem përcjelljen e informacionit nëse për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 21.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, ka ndonjë ankesë tjetër nga operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK të administruar në KPP, përveç asaj të datës 11.01.2024, me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024?*

II.12. Me memon me nr. 72/8 prot., datë 31.01.2024, Sektori i Financës Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në KPP njofton, se: *“Ju konfirmojmë se operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK nuk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik në rrugë shkresore ankesë tjetër përveç asaj të datës 11.01.2024, me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 protokollin datë 11.01.2024, për procedurën e prokurimit me nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë, autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1.”*

II.13. Me memon me nr. 72/8 prot., datë 31.01.2024, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit në KPP njofton se: *“[...] Në sistemin e ankesave elektronike nuk gjendet asnjë ankesë tjetër nga operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK për procedurën e prokurimit me Nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 21.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, përveç asaj me nr.72/2024 prot., datë 11.01.2024 dhe nr. aplikimi A/2024/3749.”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, së pari vlen të theksojmë se operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit më datë 11.01.2024, si pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024. Sqarojmë, se që në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë, paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave. Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, është kryer një cikël trajnimesh falas, në 12 qarqe të Shqipërisë, ku janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet të cilat zhvillojnë procedura prokurimi, si dhe operatorë ekonomikë, të cilët janë njohur mbi mënyrën e funksionimit dhe përdorimit të këtij sistemi. Akoma më tej, më datë 11.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, përmes komunikimit elektronik zyrtar, e ka njoftuar autoritetin kontraktor për paraqitjen e ankesës së sipërpërmendur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për kryerjen e disa veprimeve procedurale në sistemin elektronik të ankesave, me qëllim zbatimin e procedurave ligjore.

Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues “Igli Pellet” SHPK, ka paraqitur ankim në rrugë elektronike për procedurën e mësipërme të prokurimit më datë 11.01.2024, me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024, i cili konsiderohet i dorëzuar njëkohësisht në të dyja institucionet, si në autoritet kontraktor ashtu dhe në Komisionin e Prokurimit Publik.

III.2. Në datën 30.11.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 21.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1.

III.2.1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 21.12.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

III.2.2. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se në datën 05.01.2024, është bërë vlerësimi i procedurës dhe klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, ku ankimuesi rezulton i skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik “IGLI PELLETT” SH.P.K me nipt: NIPT L64715601E nuk plotëson pikën 2.3 të kapaciteteve teknike lidhur me kontratat e ngjashme pasi ka paraqitur vetëm vërtetimin për realizimin të pashoqëruar me fatura elektronike të institucioneve shtetërore, çka bie në kundërshtim me përcaktimin Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

III.2.3. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 11.01.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe

njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024, e operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit.

III.2.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 72/2 datë 12.01.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

III.2.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 15.01.2024, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.2.6. Përmes shkresës së protokolluar me tonën me nr. 72/3 prot., datë 19.01.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Igli Pellet” SHPK, bashkëlidhur së cilit gjendet dokumenti me nr. 1314/18 prot., datë 19.01.2024, me lëndë “Shqyrtim Ankesë”. Referuar dokumentit më sipër, dy prej anëtarëve të KSHA kanë vendosur mospranimin e ankesës (e cila sipas informacionit të tyre është paraqitur në protokollin e shoqërisë me nr. 1314/15 prot, datë 15.01.2024) me argumentimin, se ankimuesi me dokumentacionin e dorëzuar nuk plotëson të gjitha kriteret për kualifikim, ndërsa njëri prej anëtarëve të KSHA ka dalë me mendim paralel, duke vendosur mospranimin e ankesës me arsyetimin, se ankesa e operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK e depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, më datë 11.01.2024, konsiderohet si e paraqitur përpara afatit, duke mos u legjitimuar.

III.2.7. Me shkresën nr. 1314/21 prot, datë 19.01.2023, me objekt: “*Informacion*” protokolluar me tonën me nr. 72/4 prot., datë 22.01.2024, është dërguar përmes shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK.

III.2.8. Me datë 25.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 72/5 prot., operatori ekonomik “Igli Pellet” ka paraqitur përmes sistemit të ankesave elektronike formularin e paraqitjes së argumenteve.

II.2.9. Me shkresën e datës 23.01.2024, me lëndë “Ankesë” dhe objekt: “Dërgimi i argumenteve/kundërshtimeve në lidhje me Vendimin e Komisionit të Ankimit”, protokolluar me tonën me nr.72/6 prot., datë 29.01.2024, operatori ekonomik “Igli Pellet” ka kundërshtuar vendimin e KSHA për skualifikimin e tij, ku ndër të tjera shprehet se: “*Së treti; Saktësojmë që procesi i vlerësimit të ofertave është kryer me datë 05.01.2024, konfirmimi i njoftimit të fituesit është aprovuar në SPE me datë 15.01.2024 dhe njoftimi i fituesit është publikuar me date 15.01.2024 dhe ankesa jone juridikisht është administruar nga ana Juaj me date 15.01.2024, date me te cilen është publikuar edhe njoftimi i fituesit dhe fillon afati i ankimit i dërguar në S.P.E, qe korrespondon me protokollimin e ankesës ne institucionin e A.K-së, vërtetuar kjo me nr. Prot 1314/15, datë 15.01.2024.*”

III.2.10. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se më datë 15.01.2024, është publikuar në SPE, njoftimi i fituesit paraprak.

III.2.11. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8, “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**”.

III.2.12. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.2.13. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, **është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.**

Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se më datë 15.01.2024, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. KPP vëren, se operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK, më datë 11.01.2024, përmes sistemit elektronik të ankesave, ka dorëzuar ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024, pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku kërkon kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se më datë 15.01.2024, është publikuar në sistem, njoftimi i fituesit paraprak, moment procedural nga i cili fillon afati i ankimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.2.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të administruar, rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 11.01.2024, me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024, nuk ka filluar ende, për sa kohë autoriteti kontraktor në këtë datë (11.01.2024), nuk kishte publikuar ende njoftimin e fituesit paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik më datë 11.01.2024 përmes sistemit elektronik të ankesave, me numër ankimi elektronik A/2024/3749 dhe me nr. 72/2024 prot., datë 11.01.2024, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, nuk kanë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesave nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30,dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesat e operatorit ekonomik “Igli Pellet” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-89057-11-24-2023, me objekt: “Blerje lëndë djegëse Pellet dhe Dru zjarri”, me fond limit 13,883,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 21.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Igli Pellet” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

